

**PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Neni 5 Personat e siguruar

1. Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor dhe pagesa e kontributeve përkatëse janë të detyrueshme për të gjithë personat ekonomikisht aktivë, me banim të përhershëm në Shqipëri, si:

a) të punësuarit;

b) personat e vetëpunësuar; "me përjashtim të pensionistëve të vetëpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike profesionale, sipas nenit 7, të këtij ligji, të cilët nuk kanë detyrimin për të paguar kontribute të sigurimeve të kujdesit shëndetësor". (Shtuar me ligjin 145/2015 date 17.12.2015) (Pjesa e shtuar Shfuqizohet me Aktin Normativ Nr.1 date 25.01.2017 Botuar ne F.Zyrtare 11/2017 dale nga shtypi me 27.01.2017)

c) punonjësit e papaguar të familjes; "për tatimpaguesit e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave". (Shtuar me ligjin 145/2015 date 17.12.2015) (Pjesa e shtuar Shfuqizohet me Aktin Normativ Nr.1 date 25.01.2017 Botuar ne F.Zyrtare 11/2017 dale nga shtypi me 27.01.2017)

ç) persona të tjerë ekonomikisht aktivë.

Neni 6 Detyrimi për të paguar kontributet

1. Punëdhënësit, për vete dhe të punësuarit e tyre, personat e vetëpunësuar dhe punonjësit e papaguar të familjes për tatimpaguesit e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave janë përgjegjës për llogaritjen e saktë dhe për pagesën e kontributeve, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore. (Shtuar me ligjin 145/2015 date 17.12.2015) (Pjesa e shtuar Shfuqizohet me Aktin Normativ Nr.1 date 25.01.2017 Botuar ne F.Zyrtare 11/2017 dale nga shtypi me 27.01.2017)

Neni 7 Baza për llogaritjen e kontributeve**

3. Baza për llogaritjen e kontributit për punonjësit e vetëpunësuar është dyfishi i pagës minimale për efekt të llogaritjes së kontributeve. Paga minimale, për efekt të llogaritjes së kontributeve për të vetëpunësuarit në qytet dhe në fshat, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

"Për kategori të veçanta personash, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike profesionale, përfshirë edhe punonjësit e papaguar të familjes që punojnë e bashkëtojnë me të vetëpunësuarin, profesionet, paga për efekt të llogaritjes së kontributeve, nga paga minimale deri në pagën maksimale, si dhe kriteret e përcaktimit të saj caktohen nga Këshilli i Ministrave." (Shtuar me ligjin 145/2015 date 17.12.2015)

(Ky paragraf Shfuqizuar me Aktin Normativ Nr.1 date 25.01.2017 Botuar ne F.Zyrtare 11/2017 dale nga shtypi me 27.01.2017)